



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1858/9 prot

Datë 29.10.2021

**V E N D I M**

**K.P.P.824/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.10.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-05071-09-13-2021, me objekt: “Rivlerësim Asetesh të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kruje SH.A”, me fond limit 3.700.000 (tre milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës-Kanalizime Krujë SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “HH Consulting & Services Studion” SHPK, nga procedura e mësipërme e prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK  
Rruga “Jusuf Vrioni”, Pallati Alison, shkalla II, kati 2,  
Tiranë.

- Autoriteti Kontraktor:** Ujësjellës-Kanalizime Krujë SH.A.  
Barabit Ndërtesë 2 Katëshe.
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “HH Consulting & Services Studio”  
SHPK  
Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga Frederik Shiroka, Kulla 3,  
Shkalla 3, Kati 2, Nr.4, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” , Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.09.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-05071-09-13-2021, me objekt: “*Rivlerësim Asetesh të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Krujë SH.A.*”, me fond limit 3.700.000 (tre milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës-Kanalizime Krujë SH.A.

II.2. Në datën 24.09.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 28.09.2021, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

“6D - PLAN”	3,500,000.00 lekë	skualifikuar
“HH CONSULTING & SERVICES STUDIO”	3,600,000.00 lekë	kualifikuar
“UNITEC-STUDIO”	4,000,000.00 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 28.09.2021 operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, sipas argumentimi/arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon:

*“Kjo OE skualifikohet për arsytet e mëposhtme:*

*1-OE nuk ka siguruar ofertën sipas shtojcës nr. 3 në bazë të ligjit Nr. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, neni 83 Sigurimi i ofertës 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*2- Në kriterin 2.3.2 “Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar në institucionin licencues në të tre fushat e kërkuara (shkalla e parë) nga jo më pak se 2 vjet, me të drejtë të ushtrorë aktivitetin e vlerësimit pa asnjë kufizim në fushat e mëposhtme sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 712, datë 12.10.2016....” Saktësisht Pika c) Për Linja teknologjike, makineri e pajisje. (Shkallë e parë) O.E e disponon një certifikatë të shkallës së parë si person juridik por kjo certifikatë ka një afat më pak si dy vite çka nuk e plotëson afatin e vendosur në kriterin e kualifikimit 2.3.2 nga jo më pak se dy vjet.*

*3- Në kriterin 2.3.5 O.E nuk disponon numrin 3 të eksperteve vlerësues me certifikatat përkatëse të kërkuara në kriterin 2.3.5, më saktë ka 4 ekspertë që disponojnë certifikatën*

*e shkallës së parë të kërkuar në pikën “a” të kriterit “Për Ndërtesa dhe tokë truall, (Licencë të shkallës së parë)” dhe 1 (një) ekspert vlerësues që disponon kategoritë e certifikatave të kërkuara në pikën “b” dhe “c” të kriterit. Sa më saktë në kriterin 2.3.5 nuk janë kërkuar thjesht ekspertë që disponojnë certifikata të këtyre kategorive për këto certifikata të disponohen nga 3 ekspertë të ndryshëm sepse ky kriter është vendosur duke u bazuar në natyrën që ka ky objekt prokurimi dhe afatin që duhet të përfundojë kjo procedurë. Ritheksojmë se ky proces bëhet për herë të parë nga AK -UKK dhe është shumë i rëndësishëm, sidomos në afatet dhe cilësinë e tij, pasi rivlerësimi i aseteve të UKK do të jetë i një rëndësie të veçantë për UKK dhe si i tillë është interes i AK që ky proces të kryhet nga OE të cilët garantojnë cilësinë për të cilën ky proces mos të jetë i kontestueshëm përgjatë procesit të mëvonshëm për institucionin e UKK.*

*4- Në Kriteri 2.3.6 OE nuk ka ngarkuar në sistem asnjë dokumentacion mbi këtë kriter. 5- Ky OE Nuk plotëson kriterin 2.3.7 OE nuk ka ngarkuar në sistem asnjë certifikatë vlerësimi nga subjekte shtetërore apo private .*

*6- Ky OE Nuk plotëson kriterin 2.3.8 OE nuk ka ngarkuar në sistem vërtetimin që nuk ka marrë asnjë sanksion në tre vitet e fundit për shkelje nga Komisioni i Posaçëm i Licencave”.*

II.5. Në datën 29.09.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 146, më datë 04.10.2021

II.6. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se në buletin nr. 146, datë 04.10.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku rezulton fitues operatori ekonomik “HH CONSULTING & SERVICES STUDIO” SHPK.

II.7. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se operatori ekonomik ankimues “6D-Plan” SHPK ka paraqitur ankesë në datën 06.10.2021, pranë autoritetit kontraktor dhe në datën 04.10.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “6D-Plan” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës “HH Consulting & Services Studio” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1858/2 prot., datë 05.10.2021 lidhur

me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “6D-Plan” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës “HH Consulting & Services Studio” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.9. Me formularin e paraqitjes së argumenteve me nr. 1858/3 prot., datë 08.10.2021, operatori ekonomik “HH Consulting & Services Studio” SHPK në cilësinë e operatorit ekonomik, i cili ka interes në këtë procedurë prokurimi, ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me argumentet (kleime) në lidhje me ankesën me nr. REF-05071-09-13-2021.

II.10. Me shkresën me nr. 877 prot., datë 12.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1858/4 prot., datë 13.10.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “6D-Plan” SHPK dhe me shkresën nr. 877 prot., datë 12.10.2021, e ka njoftuar atë, se ka vendosur mos pranimin të ankesës.

II.12. Me shkresën me nr. 10/14 prot., datë 14.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1858/5 prot., datë 19.10.2021, operatorit ekonomik “6D-Plan” SHPK ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me kthim përgjigje lidhur me trajtimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.13. Me shkresën nr. 1858/6 prot., datë 20.10.2021 me lëndë “Kërkesë për informacion” drejtuar operatorit ekonomik “6D-Plan” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar nga ankimuesi të dorëzojë pranë KPP dokumentacion të nevojshëm në cilësinë e provës, për të vërtetuar marrjen dijeni mbi Njoftimin e Fituesit, brenda orarit zyrtar të datës 21.10.2021.

II.14. Me shkresën nr. 10/22 prot., datë 22.10.2021 protokolluar me tonën me nr. 1858/7 prot., datë 25.10.2021 me lëndë “Kthim-përgjigje”, operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK ka dërguar printscreen e SPE të rubrikës mesazhe dhe Komisioni konstatoi se, operatori ekonomik ankimues nuk ka marrë dijeni mbi Njoftimin e Fituesit.

II.15. Me shkresën me nr. 1858/8 prot., datë 28.10.2021, operatori ekonomik “HH Consulting & Services Studio” SHPK në cilësinë e operatorit ekonomik, i cili ka interes në këtë procedurë prokurimi, i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar informacion në lidhje me vendimmarrjen.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### Arsyeton

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK, Komisioni vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e kushteve formale të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku një prej të cilave është respektimi i afateve të ankimit.

III.1.1. Në nenin 4, pika 41, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcaktohet se:

*“Sistem i prokurimit elektronik” është një bazë të dhënash shtetërore, e krijuar sipas legjislacionit në fuqi e që përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit publik dhe administrohet nga Agjencia e Prokurimit Publik”*

III.1.2. Në nenin 97, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është parashikuar se:

*“1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.*

*2. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Me publikimin e njoftimit të fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.”*

III.1.3. Në datën 20.10.2021, me anë të shkresës nr. 1858/6 prot., Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga operatori ekonomik ankimues “6D-Plan” SHPK, që të paraqesë pranë KPP-së, një “Printim ekrani” të mesazheve që i janë dërguar këtij të fundit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) nga autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe çdo provë tjetër që vërteton marrjen dijeni nga ankimuesi mbi njoftimin e fituesit.

III.1.4. Në datën 25.10.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1858/7 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimues “6D-Plan” SHPK, me anë të së cilës ka bashkëlidhur “Printim ekrani” të rubrikës mesazhe në llogarinë e tij në SPE, me anë të së cilës vërteton se nuk është njoftuar nëpërmjet SPE lidhur me njoftimin e fituesit.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje pikën 2 të nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar,*

*operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”. Ndërsa në formularin e njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr.146, datë 04.10.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, i cili është formular standard i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe është i përfshirë në dokumentet standarde të tenderit, përcaktohet: “Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.*

III.1.6. Sa më sipër, bazuar në përcaktimet sipërcituara, si dhe bazuar në parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik, Komisioni gjykon se në rastin konkret, përlllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nis nga dita e marrjes dijeni nga operatorët ekonomik mbi njoftimin e fituesit dhe përfundon ditën e shtatë. Komisioni thekson se për sa kohë që, operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK, nuk ka marrë dijeni nëpërmjet SPE mbi njoftimin e fituesit, si dhe për sa kohë që në formularin standard të njoftimit të fituesit, të publikuar në buletin nr.146, datë 04.10.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është përcaktuar se me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, atëherë përlllogaritja e afateve për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, do të nisë nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në këto kushte, Komisioni gjykon se në rastin konkret, përlllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë sipas nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nis që nga data 04.10.2021, dhe përfundon në ditën e shtatë. Sa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik “6D-Plan” SHPK është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në bazën ligjore të sipërcituar, e për rrjedhojë Komisioni vendosi të shqyrtojë në themel këtë ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “6D-Plan” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së vet, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : “[...]Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e publikuara në dokumentet e tenderit për këtë procedurë prokurimi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet standarde të tenderit, konkretisht në seksionin 3 është përcaktuar:

### **Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike**

**3.1 Sigurimi i ofertës:** (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

*Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

*Shuma e sigurimit të ofertës është 74.000 (shtatëqind e dyzet mijë) lekë.*

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 \_\_\_\_\_ (shuma, monedha)

Loti 2 \_\_\_\_\_ (shuma, monedha)

**3.1.2** Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor **AL10202130080000000001860299 Raiffeisen Bank sh.a** të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor).

**3.1.3** Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare x

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente x

**3.2** **Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150** (shprehur në ditë).

-Ndërsa në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1.b. kriteret e veçanta të kualifikimit, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

## “2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3”.

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, **nuk ka dorëzuar asnjë “Sigurim oferte”.**

III.2.4. Në nenin 77, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.



5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 83 “Sigurimi i ofertës” ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor.

Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Në nenin 15 “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit”, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:

- sigurimin e ofertës;”.

Në nenin 30 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti kontraktor duhet të

kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

*Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.*

*Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

*3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe”.*

Në nenin 41, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.

III.1.6. Në nenin 83 pikat 1 dhe 2 të LPP ndër të tjera parashikohet se 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Referuar interpretimit sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se lex specialis ka parashikuar detyrimin e dorëzimit të sigurimit të ofertës nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në të gjitha procedurat e prokurimit me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël si një garanci kundrejt autoritetit kontraktor (institucionit publik) në rastet e parashikuar nga neni 83 i LPP dhe neni 30 i Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. K.P.P. gjykon se është detyrim i autoritetit kontraktor, të specifikojë në dokumentet e tenderit çdo kërkesë për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës. Në

dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Në lidhje me formën e lejuar të sigurimit të ofertës, kuadri ligjor në fuqi i ka lënë mundësinë autoritetit kontraktor të përzgjedhë një nga dy format e parashikuar në nenin 83 të LPP-së (formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari).

III.1.7. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit *“Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e publikuara në dokumentet e tenderit për këtë procedurë prokurimi”*, Komisioni Prokurimit Publik konstaton, se sipas parashikimeve të dispozitave ligjore të sipërcituara, operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në të gjitha procedurat e prokurimit me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, duhet të paraqesin edhe **sigurimin e ofertës**, e cila dhe duhet të jetë e vlefshme, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës, si një garanci kundrejt autoritetit kontraktor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), shoqëria *“6D-Plan” SHPK nuk ka dorëzuar asnjë “Sigurim oferte”*, sipas kërkesave të vendosura në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në përfundim të analizës së fakteve të sipërcituara, Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik *“6D-Plan” SHPK* në procedurën e prokurimit objekt-ankimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), është jo i plotë dhe nuk është në përputhje me formën e kërkuar sipas kërkesave të veçanta të kualifikimit, të hartuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues *“6D-Plan” SHPK* për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërme nuk qëndron, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“6D-Plan” SHPK*, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik *“HH Consulting & Services Studion” SHPK*, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen: *“Mbështetur te regjistri i shoqërive që disponojnë licencë për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës (<https://www.infrastrutura.gov.al/regjistrat/>) operatori ekonomik “HH Consulting & Services Studion” SHPK rezulton i licencuar vetëm në dy kategori nga 3 (tre) kategori që keni kërkuar në DST, më konkretisht:*

*-me licencën nr. VSH. 1858/2, kategoria/fusha NTT e vlefshme deri në 18.03.2026 (pra është marrë nga OE vetëm në Mars 2021 dhe nuk i plotëson kriterin e periudhës 2 vjeçare).*

*-me licencën nr. VSH. 1492/1, kategoria/fusha LTMP e vlefshme deri me 03.09.2026 (pra është marrë nga OE vetëm në shtator 2021 dhe nuk i plotëson kriterin e periudhës 2 vjeçare).*

*-AK jo vetëm që ka skualifikuar në mënyrë të padrejtë OE “6D-Plan” SHPK ku ky i fundit i ka të 3 (treja) kategoritë e licencave për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, por ka shkelur parimin e barazisë në tender duke trajtuar me dy standarde OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.*

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “6D-Plan” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “HH Consulting & Services Studion” SHPK, KPP sjell në vëmendje të ankimuesit, neni 94, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 94, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste, kur operatorit ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatorit ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-05071-09-13-2021, me objekt: “Rivlerësim Asetesh të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kruje SH.A”, me fond limit 3.700.000 (tre milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës-Kanalizime Krujë SH.A.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “6D-Plan” ShPK.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**